



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**VENDIM**

**nr. 418, datë 30/05/2016**

**“Për disa rekomandime mbi vendimin e Këshillit Administrativ të FSDKSH-së mbi kriteret që duhet të plotësojnë farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për lidhjen e kontratave me Fondin”**

Komisioni i Konkurrencës, i përbërë nga:

▪ Lindita	MILO (LATI)	Kryetare
▪ Servete	GRUDA	Zv/Kryetare
▪ Koço	BROKA	Anëtar
▪ Iva	ZAJMI	Anëtare
▪ Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.05.2016 trajtoi çështjen me:

**Objekt :** Vlerësimin e kërkesës së Urdhrit të Farmacisteve në lidhje me Vendimin nr. 71, datë 22.12.2015, të Këshillit Administrativ të FSDKSH”;

**Baza ligjore:** Neni 24, germa f), neni 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të:

- Raportit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi vlerësimin e kërkesës së Urdhrit të Farmacisteve në lidhje me Vendimin nr. 71, datë 22.12.2015, të Këshillit Administrativ të FSDKSH-së;
- Seancës dëgjimore me përfaqësues të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë datë 31.03.2016
- Pretendimeve në seancën dëgjimore me kryetarin e Këshillit Administrativ të FSDKSH-së datë 13.05.2016;

**VËREN SE:**

1. Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë i është drejtuar Autoritetit të Konkurrencës me një kërkesë për interpretimin e Vendimit nr. 71, datë 22.12.2015, të Këshillit Administrativ të FSDKSH-së (Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor).
2. Sipas shkresës së Urdhrit, Vendimi nr. 71, datë 22.12.2015 “Për kriteret që duhet të plotësojnë farmacitë dhe agjensitë farmaceutike për lidhjen e kontratave me Fondin dhe procedurat për lidhjen e kontratave për vitin 2016” i Këshilli Administrativ i Fondit, në pikat 10,13,14 dhe 15 ka përcaktuar kriteret që do kontraktohen nga Fondin; Konkurrencë të pa drejtë ndërmjet subjekteve farmaceutike, diskriminim të një numri subjektësh farmaceutike, ndonëse ato e zhvillojnë aktivitetin konform rregullave ligjore në fuqi”.
3. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të neneve 28 dhe 33 të Ligjit nr. 9121 datë 27.08.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ka ndjekur procedurat ligjore për vlerësimin e kërkesës së Urdhrit të Farmacistëve në lidhje me vendimin objekt-ankese. Subjekti nuk legjitimohet si palë ankuese për shkak të kufizimit të tij ligjor sipas Ligjit nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në RSH”, por në kuptim të neneve 69 dhe 70 të Ligjit, Autoriteti ka vlerësuar konkurrencën në tregun përkatës, aktet ligjore dhe nënligjore mbi të cilat funksionon ky treg, si dhe ndikimin e tyre në konkurrencë.
4. Kriteret e vendosura në pikat 10 dhe 14 të Vendimit nr. 71, datë 22.12.2015 të Këshillit Administrativ të FSDKSH-së, lidhur me distancën që duhet të kenë farmacitë nga kufiri i jashtëm i Institucionit Shëndetësor publik është argumentuar FSDKSH-ja, si një masë për shmangien e lidhjes abuzive mes mjekëve dhe farmacistëve. Ky kriter pretendohet se është i motivuar për rregullimin e tregut si dhe shpërndarjen e farmacive në territor për të mënjeluar mbipopullimin me farmaci pranë institucioneve shëndetësore.
5. Vlera monetare e rimbursimit të ilaçeve përben rreth 45 % të vlerës totale të tregut farmaceutik. Ky fakt është pohuar si nga përfaqësuesit e ankimuesit ashtu edhe nga FSDKSH-ja.
6. Gjatë realizimit të hartimit dhe të miratimit të këtij vendimi, i cili kushtëzon mirëfunksionimin e tregut, për vetë volumin e tij, nuk është zbatuar detyrimi ligjor sipas neneve 69 dhe 70, (pika 2), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Sipas tij duhet të realizohet vlerësimi ligjor i projekt/akteve normative periodike nga Autoriteti i Konkurrencës, akte të cilat mund të kenë për pasojë krijime barrierash për kufizime të mundshme sasiore (jo me efekt të ndjeshëm mbi konkurrencën) në tregun e shitjes më pakice të barnave të rimbursuara (dhe jo vetëm).
7. Përdorimi i kriterëve të distancave për lidhjen e kontratave të rimbursimit nuk përbëjnë kriteret që lidhen me performancën e operatorve në treg, dhe nuk kanë lidhje shkak-pasojë me sjelljen oportunistike të mjekëve-farmacitëve. Në këto kushte lind e nevojshme gjetja e instrumenteve alternativë për kontrollin e tregut objekt-vlerësimi, nëpërmjet akteve nënligjore që do të nxjerrë në vijim Këshilli Administrativ të FSDKSH-së (Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor).

## PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f), nenet 69 dhe 70, (pika 2), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

### VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Këshillit Administrativ të FSDKSH, që sipas parashikimeve të nenit 69 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të dërgojë paraprakisht pranë Autoritetit të Konkurrencës projekt aktet që në mënyre të veçante mund të sjellin kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimit.
2. Projekt vendimi dhe aktet e tjera nënligjore që përcaktojnë kriteret që duhet të plotësojnë farmacitë dhe agjencitë farmaceutike për lidhjen e kontratave me Fondin dhe procedurat për lidhjen e kontratave standarde për vitin 2017 duhet të marrin vlerësimin paraprak të Autoritetit të Konkurrencës.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij Vendimi tek Këshilli Administrativ të FSDKSH-së dhe palë të tjera të interesuara, si dhe me ndjekjen e zbatimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I KONKURRENCËS

**Servete GRUDA**

(                    )  
**Zv/Kryetare**

**Koço BROKA**

(                    )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

(                    )  
**Anëtare**

**Eduard YPI**

(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R E**